

Në vijm të kërkesës mbi të dhënat në lidhje me sasinë e konfiskuar nga **kontrabanda e parave të gatshme dhe metaleve të çmuara**, nga periudha 1 janari 2019 deri më 31 dhjetor 2022, ju sqarojme se **autoriteti përgjegjës për të kryer konfiskime** është **Prokuroria**. Duke e theksuar këtë fakt, po ju referojmë kapjet e kryera në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit.

Më poshtë gjeni vlerat sipas monedhave për periudhën e kerkuar (01.01.2019 - 31.12.2022):

EUR - 4.447.064
GBP - 937.560
USD - 96.180
CHF - 113.517
ALL - 2.826.100

Të dhëna për konfiskimin e naftës dhe derivateve të naftës në Republikën e Shqipërisë, nga 1 janari 2019 deri më 31 dhjetor 2022, Ju informojmë se;

Drejtoria e Antikontrabandës, disponon të dhëna vetëm për rastet e konstatuara, për kontrollet që kjo drejtori ka ushtruar në bashkëpunim me strukturat DPD/DOH, apo/dhe struktura të tjera ligjzbatuese, dhe jo, për të gjithë rastet e sekuestrimeve dhe konfiskimeve (që mund të jenë konstatuar nga degët doganore, apo të çdo strukture tjetër DPD/DOH, për vitet e kërkuara).

Bashkëngjitur, ju përcjellim rastet që struktura e AK/Tokësore, në bashkëpunim me GFI, kanë konstatuar shkelje, gjatë kontrolleve të ushtruara për markimin e karburantit në pikat e karburantit dhe akse, si dhe rastet, ku AK/Detare ka marrë pjesë në kontrollet e përbashkëta, duke bashkëpunuar me strukturat e tjera ligjzbatuese, gjatë viteve: **2019 - 2022**.

Raste të konstatuara, gjatë kontrolleve në pikat e karburantit & akse, nga A/K Tokësore & Inspektorët e GFI:

Data	Lloji mallit	Sasia	Lloji i shkeljes
15/02/2019	Benzinë	9,104 litra e pamarkuar	Kontrabandë
21/06/2022	Diezel	40 litra e pa markuar	K/Administrative
22/06/2022	Naftë	100 litra e pamarkuar	K/Administrative

Grupet e Antikontrabandës Detare, si pjesë e agjensive të zbatimit të ligjit në IMOC, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë, Frontex dhe GDF, kryejnë kontrolle ndaj anijeve me flamuj të huaj dhe shqiptar, me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen ndaj kontrabandës, si dhe çdo trafiku tjetër të paligjshëm, që do të cënonte garantimin e sigurisë dhe të rendit publik në porte, duke përfshirë dhe masat në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar.

Kontrolle AK/Detare/Dogana Durrës, në bashkëpunim me strukturat e tjera ligjzbatuese:

Nr.	Mjetet Kontrolluara	Data	Vendi Kontrollit	Përshkrimi
1	"M/P Leon"	08.09.2022	Porti Durrës	Datë 08.09.2022 , pas kontrollit të përbashkët të kryer në bordin e "M/P Leon", me port rregjistër Durrës, u bë plumbosja dhe bllokimi i sasisë prej 56.580 t. naftë kontrabandë nga Dogana

				Durrës, AK/Detare dhe Krimi Ekonomik D.V.P. Durrës. Vazhdon proçedimi nga strukturat e tjera ligjbatuese.
2	"A/T Majeda"	Queen	12.09. 2022	Porti Durrës
				Datë 12.09.2022 , pas kontrollit të përbashkët të kryer në bordin e anijes "Queen Majeda", me flamur Kamerun, e cila vinte nga Libia, u bë plumbosja dhe bllokimi i sasisë prej 2272.717 ton, i produktit Marine Gasoil, nga Dogana Durrës, AK/Detare dhe Krimi Ekonomik. Vazhdon proçedimi nga Prokuroria e Rrethit Durrës.